



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.04.2023

**MBLEDHJA Nr. 22,
Datë 24.04.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 24.04.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 22 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 14.04.2023
2. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, Qarku Elbasan, me kapacitet të instaluar 2850 kW
3. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018
5. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 430, seria T18, të shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 226 datë 26.10.2018
6. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 429, seria F18, të shoqërisë “Ener Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 227 datë 26.10.2018
7. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIV”
8. Mbi heqjen e licencës nr. 446, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim SHULI